

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË “BANKA CREDINS” SH.A.

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Mërkurë, datë 22 Korrik 2015, ora 14:00 në ambientet e “ BANKA CREDINS” SH.A., në adresën Rr. “Ismail Qemali” Nr. 4, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të “BANKA CREDINS” SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Vendimmarrje e Aksionareve të Bankës Credins lidhur me aksionet ende të panënshkruara të emetuara me Vendim nr.5 date 29.10.2014 të Asamblesë se Aksionareve të shoqërisë Banka Credins sh.a.
2. Propozim për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, znj. Vera Fazlli LALA, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksioner të shoqërisë “CREDINS BANK” SH.A. nepermjet kalimit të fitimit të vitit 2014.
3. Ne kuadër të procesit të bashkimit me përthithje të shoqërisë “Credins Leasing” sh.a. (shoqëria e përthithur), tek shoqëria “Banka Credins” sh.a. (shoqëria përthithëse), miratuar me Vendim nr.2 date 24.05.2013 të Asamblesë se Aksionereve të Bankes Credins sh.a, propozohet miratimi i ekspertes kontabël të autorizuar, Znj.Vera Fazlli Lala, për të certifikuar bilancin e bankes përthithëse (Bankes Credins) dhe të dhenat e detajuara për kapitalin aksioner, të përgatitura mbi baza të konsoliduara.
4. Ngarkohet Drejtoria të njoftojë Bankën e Shqipërisë dhe të bëjë regjistrimet përkatëse pranë QKR dhe QRA.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë, më 01.07.2015

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.